



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-15189 /2026

Datë: 03.06 /2026

Duke u mbështetur në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja d), dhe nenin 40, paragrafi 40.2, shkronjat c) dhe l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenin 10, pika 4), dhe nenin 40, pika 11, të Statutit të Komunës së Klinës, të miratuar në mars 2010, me kërkesën e Drejtorisë për Arsimit në Komunën e Klinës të datës 12.05.2026, me nr. prot. 01Nr.463-12929/2026, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e V-të të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më 29.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa me nr. prot. 01Nr.463-12929/2026 e Drejtorisë për Arsim për ndërrimin e titullarit të pronave, sipas të dhënave dhe dokumentacionit të paraqitur në kërkesë.
2. Pronat si në vijim:
 - Prona sipas certifikatës së pronësisë me numër të lëndës 11-828-2026, data e lëshimit 05.05.2026, evidentohet Pronë Shoqërore – Shk. Fill. Jedinstvo, parcela me nr. P-71006059-00090-2, ZK Shtupel, në sipërfaqe prej 7105 m².
 - Prona sipas certifikatës së pronësisë me numër 11-829-2026, data e lëshimit 05.05.2026, evidentohet Pronë Shoqërore – Shk. Fill. V. Karaxhiq, me nr. P-71006024-00442-3, ZK Klinë, në sipërfaqe prej 2200 m².
 - Prona sipas certifikatës së pronësisë me numër të lëndës 11-2264-2024, data e lëshimit 29.07.2026, evidentohet P.Sh. Shkol. Fil. Boro Milatinoviq Zlakuqan, parcela me nr. P-71006004-00520-1, ZK Berkovë, në sipërfaqe prej 4519 m².
 - Prona sipas certifikatës së pronësisë me nr. të lëndës 11-2264-2024, data e lëshimit 27.07.2024, evidentohet P.Sh. Shkol. Fil. Milatoviq Zlakuqan, parcela me nr. P-71006004-00520-2, ZK Berkovë, në sipërfaqe prej 3199 m².

Pas konfirmimit të ligjshmërisë së vendimit, pronat e lartpërmendura regjistrohen prona shoqërore në emër të Komunës së Klinës.

3. Ndërrimi i titullarit të pronës bëhet me qëllim të interesit publik, shfrytëzimit dhe zhvillimit të projekteve të cilat janë në interes publik, si dhe për menaxhim efikas të infrastrukturës arsimore.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunes;**
- **Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi;**
- **Drejtoria për Arsim në Komunën e Klinës;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi.**

